

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8034  
E martë, 15 prill 2025  
Çmimi 0.50 €

## Kallasi: Tensionet në Ballkanin Perëndimor po rriten

FACE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SOT NISIN HAPAT PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

FACE 4-5



Sot (e martë) është thirrur seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, e cila do t'i shënojë edhe hapat e parë për formimin e institucioneve të reja pas

zgjedhjeve të 9 shkurtit. Sipas njoftimit të Kuvendit, seanca do t'i ketë katër pika të rendit të ditës: Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit

dhe të Mandateve të Deputetëve, betimi i deputetëve, zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit

## KOSOVA, DEPONI E "MBETJEVE NJERËZORE"! F.3

Nga: KMDLNj



## GJYKIMI I IËSH-KRERËVE TË UÇK-së NË HAGË DREJT FUNDIT: ÇFARË TANI? F.4-5

- Tani që prokurorisë po i përfundon koha për t'i vërtetuar akuzat, e ardhmja e gjyqit është e pasigurt




## OPINION

### QEVERIA KURTHI 3, E 'BEKUAR' NGA PROF. DR. RAMÇE F.6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### LIMAJ: NISMA SOCIALDEMOKRATE DO TË LUJË ROL NË KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE F.3

### MACRONI: NEVOJITEN MASA TË FUQISHME PËR TA DETYRUAR MOSKËN TË PRANOJË ARMËPUSHIM NË UKRAINË F.7

## EKONOMI



### KOSOVA PËRFITON PESË MILIONË EURO GRANT NGA BERZH-i F.8

### BLERJET ONLINE NË KOSOVË: KUR ÇMIMI I LIRË KUSHTON SHUMË F.8

## SPORT



### DUKAGJINI DHE SUHAREKA KËRKOJNË KËNDELLJEN F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kallasi: Tensionet në Ballkanin Perëndimor po rriten

**BRUKSEL, 14 PRILL** - Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha se tensionet në Ballkanin Perëndimor po rriten, andaj kërkoi të vazhdojë procesi i zgjerimit të bllokut. "Po shohim se tensionet po rriten dhe definitivisht duhet të lëvizim me procesin e zgjerimit. Kjo është diçka e prekshme dhe vërtet na duhen histori suksesi", tha Kallasi para takimit të Këshillit për Punë të Jashtme që mbahet në Luksemburg.

Kallasi nuk përmendi shtetet që, sipas saj, po rritin tensionet. Por, së voni në Bosnjë-Hercegovinë, autoritetet në entitetin e Republikës Sërpska kanë ndërmarrë disa veprime që kanë rritur shqetësimet e bashkësisë ndërkombëtare për shpëputjen e mundshme të këtij entiteti serb nga Bosnja. NATO ka thënë se nuk do të

lejohej të rrezikohet paqja në Bosnjë, ndërkaq Shtetet e Bashkuara kanë thënë se po shqyrtojnë disa opsione veprimi, duke theksuar se nuk duhet të ndodhë "shpërbërja e vendit dhe një konflikt i ri".

Po ashtu, tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë - që dialogojnë për normalizim të raporteve që nga viti 2011 në Bruksel - janë të larta qysh në vitin 2023, kur kryetarët shqiptarë morën drejtimin e katër komunave në veri të banuara me shumicë serbe.

Tensionet kulmuan në shtator të po atij viti, kur një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë një rreshter. Gjatë këmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serbë. Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon se ka gisht në të.

Ndërkaq kryediplomatja evropiane tha se një natë më



parë ka pasur "darkë shumë të mirë me miqtë tanë" nga Ballkani Perëndimor. Në këtë darkë Kosova është përfaqësuar nga ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla. Përveç pjesëmarrjes në darkë,

Gërvalla dhe Kallas kanë zhvilluar edhe një takim të ndarë. Kryediplomatja Gërvalla tha se i ka kërkuar Kallasit të trajtohet si "partnere e barabartë dhe e respektuar në të gjitha proceset integruese".

Nga shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi - Kosova është e fundit sa i përket rrugëtimit të saj drejt BE-së. "E ardhmja evropiane e Ballkanit Perëndimor nuk mund të jetë e plotë pa Kosovën, dhe mbështetja për vendin tonë është mbështetje për një Evropë më demokratike, më të barabartë dhe më të bashkuar. Prania dhe angazhimi ynë i fuqishëm në rajon janë burim stabiliteti dhe sigurie për gjithë kontinentin", tha Gërvalla në "Facebook".

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por ky aplikim ende nuk është shqyrtuar nga autoritetet në Bruksel.


Kosova, po ashtu, është e vetmja në rajon që nuk e ka statusin e shtetit kandidat.

## Xi: Nuk ka fitues në një luftë tregtare

**PEKIN, 14 PRILL** - Udhëheqësi kinez Xi Jinping tha se nuk ka fitues në luftën me tarifa, teksa Pekini dhe Uashingtoni kanë vendosur tarifa të larta ndaj importeve të njëri-tjetrit.

Xi ka nisur turneun e tij në Azinë Juglindore me vizitën në Vietnam më 14 prill, duke sinjalizuar se Kina është e përkushtuar për tregtinë globale, pasi tarifën e vendosura nga presidenti amerikan Donald Trump tronditën ekonominë botërore.

Edhe pse Trumpi ka pezulluar zbatimin e disa tarifave, tarifën ndaj Pekinit prej 145-përqindësh kanë mbetur në fuqi. Kina i është



kundërpërgjigjur ShBA-së, duke vendosur po 145 për qind tarifë ndaj importeve amerikane.

"Nuk ka fitues në një luftë tregtare apo në një luftë me tarifa", shkroi Xi në një editorial

që është publikuar në mediet shtetërore të Vietnamit dhe Kinës. "Shtetet tona duhet ta mbrojnë me vendosmëri sistemin multilateral të tregtisë, zinxhirët industrialë dhe të furnizimit globalë si dhe mjedisin e hapur dhe bashkëpunues ndërkombëtar".

Xi do të zhvillojë vizitë dyditore në Vietnam.

Përderisa kjo vizitë me gjasë është planifikuar më herët, ajo është bërë e rëndësishme për shkak të luftës me tarifa në mes të Kinës dhe ShBA-së, dy ekonomive më të mëdha në botë.

Vietnami ka përvojë në balancimin e raporteve me

ShBA-në dhe Kinën. Përderisa shteti udhëhiqet nga një sistem komunist njëpartiak sikurse Kina, ai ka marrëdhënie të forta me ShBA-në.

Më 2023 Vietnami ishte shteti i vetëm që mirëpriti presidenti amerikan Joe Biden dhe atë të Kinës, Xi Jinping.

Edhe Vietnami është goditur nga tarifën e vendosura nga Trumpi në fillim të prillit, që goditën shumë shtete të botës. Ndaj këtij shteti, Uashingtoni ka vendosur tarifë prej 46-përqindësh ndaj mallrave, por tarifën e pezulluar për 90 ditë nga Trumpi. Pas Vietnamit, Xi pritet të qëndrojë në Malajzi dhe Kamboxhia.

## Macroni: Nevojiten masa të fuqishme për ta detyruar Moskën të pranojë armëpushim në Ukrainë

**PARIS, 14 PRILL** - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se nevojiten "masa të fuqishme" për ta detyruar Moskën të pranojë një marrëveshje për armëpushim në Ukrainë, pas sulmit vdekjeprurës nga ushtria ruse në Sumi. "Të gjithë e dinë këtë: kjo luftë nisi vetëm nga Rusia", shkroi Macron në X. "Dhe sot, është e qartë se vetëm Rusia po zgjedh për ta vazhduar atë, duke shpërfillur jetën e njerëzve, ligjin ndërkombëtar dhe përpjekjet diplomatike të presidentit [amerikan Donald Trump]", tha ai.

Më shumë se 32 njerëz janë vrarë të dielën nga një sulm rus me raketa në qytetin Sumi të Ukrainës, njoftuan zyrtarët.

Në mesin e të vrarëve janë dy fëmijë. Të paktën 84 njerëz të tjerë janë plagosur, përfshirë 10 fëmijë.

Ushtria ruse i hodhi dy raketa balistike në qendër të qytetit rreth orës 10:15 të mëngjesit, në kohën kur njerëzit ishin mbledhur për ta festuar të Dielën e Palmave, sipas zyrtarëve.

Sulmi ndodhi më pak se një ditë pasi diplomatët e lartë të Rusisë dhe Ukrainës akuzuan njëri-tjetrin për shkeljen e një marrëveshjeje të përkohshme të ndërmjetësuar nga ShBA për ndaljen e sulmeve ndaj infrastrukturës energjetike, duke theksuar vështirësitë e bisedimeve për t'i dhënë fund luftës trevjeçare.



Muajin e kaluar Kremli dhe Shtëpia e Bardhë shpallën pikat e përgjithshme të një armëpushimi - një ndalim i kufizuar i sulmeve ndaj infrastrukturës energjetike si

termocentralet, linjat e transmetimit, nënstacionet dhe struktura të ngjashme.

Kievi e mbështeti armëpushimin e kufizuar, me kusht që Moska t'i përmbahej

atij.

Më pas, pati një marrëveshje të përkohshme për të kufizuar luftime në rajonin e Detit të Zi, si pjesë e përpjekjeve për t'i rifilluar eksportet në shkallë të gjerë të produkteve bujqësore ukrainase dhe ruse. Megjithatë, Kremli këmbënguli për disa kushte që ekspertët e jashtëm i cilësuan të vështira, për të mos thënë të pamundura për t'u përmbushur.

Tashmë, pothuajse një muaj më vonë, armëpushimi është përqësuar deri në pikën e dështimit, ndërsa si Kievi ashtu edhe Moska vazhdojnë sulmet ditore duke përdorur dhjetëra dronë dhe raketa të fuqishme.

# SOT NISIN HAPAT E PARË DREJT FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE TË REJA

Sot (e martë) është thirrur seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, e cila do t'i shënojë hapat e parë drejt formimit të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Sipas njoftimit të Kuvendit, seanca do t'i ketë katër pika të rendit të ditës: Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve, betimi i deputetëve, zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 14 PRILL** - Partia Demokratike e Kosovës nuk do të marrë pjesë në votimin për kryeparlamentarin e ri gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të caktuar më 15 prill, pa një "zgjidhje të qëndrueshme për Kosovën". Por, ndryshe u shpreh Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila tha se në parim është për konstituimin e legjislaturës së nëntë të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit.

Deputeti i zgjedhur nga PDK-ja, Mërgim Lushtaku, tha se partia e tij mendon se zgjidhja e qëndrueshme është që kandidati i saj për kryeministër, Bedri Hamza, ta udhëheqë ekzekutivin e ri. Ai tha se PDK-ja ka zhvilluar takime me partitë e tjera që në legjislaturën e kaluar kanë qenë në opozitë, dhe u bënë thirrje të ketë "një qëndrueshmëri në premtimet që kanë bërë sa i përket moszgjedhjes së kryeministrit [aktual në detyrë, Albin] Kurti, apo mosdhënies së mundësisë [për formimin e qeverisë] Kurti 3".

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë të premtën se "një kryetar i Kuvendit që s'i ka 61 vota për vete, s'duhet të jetë kryetar i Kuvendit në radhë të parë fare". "Pra, minimalisht duhet t'i ketë 61 vota, pastaj shihemi për gjëra të tjera", ka thënë ai, pasi është pyetur në lidhje me qëndrimin e kësaj partie për votimin e kryetarit të

Kuvendit.

Megjithatë, pas regjistrimit si deputet në legjislaturën e re, kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se në parim partia e tij do të votojë për kryeparlamentarin e ri që, sipas ligjeve, duhet të propozohet nga partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit. "Kuptohet, do të bëjmë konsulta të ndërsjella edhe me partitë e tjera opozitare, me PDK-në dhe LDK-në. Por, besoj se konstituimi i Kuvendit është interes i të gjithëve", tha ai.

Ndërkaq sa i përket krijimit të qeverisë së re, Haradinaj tha se po punon që ajo të krijohet nga partitë opozitare. Megjithatë, ai tha se bërja e shumicës nga opozita është ndërlikuar për shkak të deklaratës së kreut të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, se nuk ka vija të kuqe për bashkëpunim me LV-në.

Limaj në zgjedhjet e 9 shkurtit garoi në koalicion me AAK-në dhe fitoi tri ulëse në Kuvend, ndërkaq partia e Haradinajt pesë. "Ka qenë shumë i vështirë krijimi i shumicës nga opozita. Pozicionimi i tij i hershëm e ka bërë edhe më të vështirë. Ka qenë i parakohshëm dhe nëse Nisma dhe Limaj e mbështesin pushtetin, kuptohet që ata ndahen nga ne. Por, është një ndarje mjaft e turpshme pasi kemi kërkuar votë për ndryshim dhe sjellja e tyre dhe veprimi i tyre janë mjaft të turpshëm", tha Haradinaj.



Sipas ligjeve, LV-ja, që ka fituar 48 ulëse në Kuvend, e ka të drejtën ta propozojë kryeparlamentarin. Seanca konstituive, e caktuar për të martën, konsiderohet e përmbyllur vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e deputetët e rinj ta kenë bërë betimin.

Për votimin e kryetarit kërkohen 61 vota. Vetëm pas kësaj, LV-ja do të mund t'i vazhdojë përpjekjet për ta formuar qeverinë e re, për të cilën kërkohen 61 vota.

Më herët Kurti kishte thënë se mëton që brenda një dite të konstituohet Kuvendi dhe të formohet qeveria. Megjithatë, më herët gjatë së hënës, ministri në detyrë për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq, deklaroi për gazetarët se nuk është optimist që të martën do të votohet për Qeverinë e re të Kosovës.

LV-ja ka thënë më herët se pëlqen një ekzekutiv me partitë nga komunitetet joserbe, por së fundi ka pranuar se i duhet bashkëpunimi edhe me një parti shqiptare.

AAK-ja dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë shprehur kundër bashkëpunimit me LV-në për qeverinë, Nisma nuk i ka vendosur vija të kuqe, ndërkaq Hamza nga PDK-ja ka thënë se ndonëse nuk ka vija të kuqe për asnjë parti, pëlqen një ekzekutiv pa LV-në.

Megjithatë, Kurti nuk e ka mbështetur plotësisht dhe të partive joserbe - që tradicionalisht kanë mbështetur qeverinë. Disa nga partitë joserbe, që kanë dhjetë ulëse në Kuvend, kanë paraqitur kërkesa në këmbim të votës së tyre për qeverinë. Nëse LV-ja dështon ta formojë qeverinë, është në dorën e presidentes Vjosa Osmani të mandatojë një subjekt politik që dëshmon se i ka numrat.

PDK-ja, partia e dytë e dalë në zgjedhje me 24 vende në Kuvend, ka thënë se është e gatshme ta marrë këtë përgjegjësi. LDK-ja, me 20 ulëse, ka vendosur kusht për bashkëpunimin me partitë opozitare. Kushti është marrja e pozitës së kryeministrit, por PDK-ja ka thënë se kjo pozitë i takon asaj. AAK-ja, ndërkaq, nuk ka vendosur asnjë kusht për një koalicion të mundshëm me partitë opozitare.

## Krasniqi: Do ta votojmë kryeparlamentarin dhe qeverinë Kurti

Grupi i komuniteteve joserbe ka bërë me dije se do ta mbështesë kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Kuvendit si dhe qeverinë që, sipas tyre, do të udhëhiqet nga Albin Kurti.

Ministri në detyrë i Administratës së Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, para medieve ka theksuar se ata tashmë e dinë emrin që do të propozohet nga LV-ja për kryeparlamentar, por zgjedhjen të mos e bëjnë publik. "Ne jemi grupi parlamentar i komuniteteve. Në këtë grup do të jenë së paku edhe dy deputetë të KDTP-së, partisë turke. Aktualisht jemi shtatë, që nënkupton se do ta votojmë kryetarin e Kuvendit dhe qeverinë", ka shprehur Krasniqi.

Ai ka theksuar se përkrahja për qeverinë Kurti është e natyrshme, duke theksuar rezultatin e fortë që kjo parti ka marrë në zgjedhje. "Ne jemi për qeverinë Kurti, për shkak se Kurti i ka fituar zgjedhjet dhe e ka shumicën e shqiptarëve. Edhe tash po i relativizojmë numrat - është 42.3 %, thuhet sa të gjithë të tjerët bashkë", ka theksuar ai.

Edhe deputetja boshnjake dhe kryetarja e NDS-së, Emilja Rexhepi, ka theksuar se nesër do ta votojnë emrin e propozuar nga LV-ja për kryetar të Kuvendit. "E shohim tani si është procedura dhe unë besoj që qeveria Kurti 3 votohet shpejt. Se kush është kandidat për kryeparlamentar ne e dimë, mirëpo duhet ta thotë kryeministri", ka shtuar ajo.

## LIMAJ: NISMA SOCIALDEMOKRATE DO TË LUAJË ROLIN PËR KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE



**PRISHTINË, 14 PRILL** - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë të hënën se vendin e presin shumë sfida në shumë plane. Ai ka thënë se Kosova më shumë se kurrë ka nevojë për një ecje të fuqishme ekonomike, për një dinamizim të politikës së jashtme dhe të partneritetit me miqtë. "Ne presim që institucionet të

krijohen sipas afateve kushtetuese. Ne do ta luajmë rolin tonë në krijimin e këtyre institucioneve për aq sa na takon dhe kërkohet nga ne, dhe këtu përfundon detyra jonë kushtetuese", ka thënë Limaj.

Kur u pyet nëse Nisma ka marrëveshje me ndonjë parti politike, Limaj ka thënë se si parti politike nuk kanë

marrëveshje me askënd. "Nisma nuk ka marrëveshje me askënd deri më sot. Nisma është e gatshme dhe do të punojë fort që Kosova t'i formojë institucionet dhe Kosova mos të shkojë në krizë parlamentare. Ajo që mund të them është se deri më tani nuk kemi marrëveshje me asnjë grup politik. Do të shohim nga nesër e tutje", ka thënë Limaj.



## GJYKIMI I ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË HAGË DREJT FUNDIT: ÇFARË TANI?

**- Tani që prokurorisë po i përfundon koha për t'i vërtetuar akuzat, e ardhmja e gjyqit është e pasigurt**

PRISHTINË, 14 PRILL - Për dy vjet mbi 125 dëshmitarë të ftuar nga Prokuroria e Specializuar kanë dhënë dëshmitë e tyre lidhur me akuzat që rëndojnë mbi ish-krerët e UÇK-së. Tani që prokurorisë po i përfundon koha për t'i vërtetuar akuzat e saj, e ardhmja e gjyqit është e pasigurt. Në tetor të vitit 2020 ishte konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi akuzohen se kishin qenë pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale" që shënjestronte ata që i

konsideronte "kolaboracionistë" dhe "tradhtarë" për të "fituar pushtet" gjatë dhe pas luftës së fundit në Kosovë. Avokatët e të akuzuarve kanë hedhur poshtë të gjitha akuzat që rëndojnë ndaj klientëve të tyre, duke argumentuar se UÇK-ja nuk kishte një strukturë komande efikase. Në kohën e ngritjes së aktakuzës, Thaçi kishte qenë president i Kosovës; Veseli, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK); Selimi, deputet dhe udhëheqës i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV); dhe Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës. Të katërt, sipas prokurorisë, mbanin

pozita të larta edhe përgjatë kohës që mbulon aktakuza. Por, që nga 4 dhe 5 nëntori 2020 të katërt ndodhen në paraburgim në Hagë, ku ndodhen Dhomat e Specializuara të Kosovës. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar - të njohura gjerësisht si Gjykata Speciale - janë themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Holandë. Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Të katërt të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi ta. Tani, pas intervistimit të 125 dëshmitarëve, prokuroria do ta mbyllë rastin e saj më 15 prill. Topi tani kalon në anën e ekupeve mbrojtëse, që do të tentojnë të dëshmojnë se pretendimet e prokurorisë nuk

qëndrojnë. Përderisa avokatët nga ekipet mbrojtëse të Selimit, Veselit dhe Krasniqit nuk u janë përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë", avokati i Thaçit, Lluka Mishetiç, ka thënë vetëm se është ende herët për të diskutuar se si do të organizohet mbrojtja. Më parë, më 13 nëntor të vitit të kaluar, Mishetiç kishte thënë për "REL"-in se ekipi mbrojtës i Thaçit nuk ka vendosur ende nëse do të thërrasë ndonjë dëshmitar. "Nëse e bëjmë, nuk do të jenë më shumë se dhjetë dëshmitarë", kishte thënë Mishetiç. Mishetiç ka përvojë në gjyqetë tilla. Më parë ai kishte mbrojtur ish-gjeneralin kroat Ante Gotovina para Tribunalit të Hagës, i cili ishte akuzuar për krime kundër serbëve gjatë operacionit ushtarak-politor kroat "Stuhia" më 1995. Gotovina fillimisht ishte dënuar me 24 vjet burgim, por pas apelimit të vendimit nga Mishetiç, vendimi ishte përmbytur dhe Gotovina ishte shpallur i pafajshëm.

**Pse nuk pritet të ftohen më shumë dëshmitarë nga mbrojtja?**

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), beson se Prokuroria e Specializuar nuk ka arritur vetë të dëshmojë atë që kishte pretenduar në aktakuzë. "Dy pjesë të aktakuzës që kanë qenë të rënda, ku thuhet se ka pasur ndërmarrje të përbashkët kriminale apo edhe zinxhir komandues... Në këtë pjesë mund të themi që prokuroria gjatë këtyre viteve nuk ka qenë në gjendje të vërtetojë, në bazë të analizës sonë, se një gjë e tillë ka ekzistuar në praktikë", thotë Miftaraj për "Radion Evropa e Lirë". Menjëherë pas deklaratave hyrëse të këtij gjyqi dy vjet më parë, dy ekspertë të huaj të drejtësisë ndërkombëtare - Mathias Holvoet dhe Aidan Hehir - kishin thënë se do të ishte e vështirë të vërtetohej se ish-krerët e UÇK-së janë

fajtorë për krimet e supozuara. Si shembull që tregon se sa e vështirë është që një lidhje e tillë të dëshmohet, ata u ishin referuar aktgjykimeve të Tribunalit të Hagës në rastet ndaj ish-eporëve të UÇK-së, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, të cilët u shpallën të pafajshëm lidhur me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

### Çfarë mund të presim tani?

Tani që topi ka kaluar në fushën e ekipit mbrojtës, gjithçka varet nga strategjia që vendosin ekipet mbrojtëse të të akuzuarve. Sipas Miftaraj, opsioni i parë është kërkesa nga mbrojtja për hedhjen poshtë të aktakuzës. “Nëse gjykata vlerëson se procesi gjyqësor duhet të vazhdojë, atëherë varet prej mbrojtjes se sa dëshmitarë do të ftojë, sa i duhet kohë për t’i përgatitur dëshmitarët e tyre, pastaj nis faza e fundit, që është marrja në pyetje nga ana e mbrojtësve të viktimave që, gjithashtu, mund ta marrin kohën e tyre për të marrë në pyetje dëshmitarët e tyre”, thotë Miftaraj. Megjithatë, ai pret që i gjithë procesi të mbyllet brenda këtij viti ose, më së voni, deri në pranverën e vitit të ardhshëm. Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe mbrojtja e Thaçit s’kanë dashur të komentojnë mbi kohëzgjatjen e procesit.

Por, një gjë që ishte përfolur disa herë si opsion është lirimi i të akuzuarve nga paraburgimi në Hagë pas përfundimit të intervistimit të dëshmitarëve nga Prokuroria. Në nëntor të vitit të kaluar, kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Ekaterina Trendafilova, kishte thënë se u takon gjykatësve të vendosin nëse do t’i lirojnë nga paraburgimi të akuzuarit pasi Prokuroria e Specializuar ta përfundojë rastin. Miftaraj thotë se një e tillë do të duhej të ndodhte tani, pasi arsye kryesore e paraburgimit të tyre ishte frika se po të mбетeshin në liri, do të mund të ndikonin në dëshmitarët e ftuar nga Prokuroria. “Mundësitë që të pandehurit të kenë ndikim në dëshmitarët e Prokurorisë tani janë zero sepse kanë përfunduar. Kështu që, sikur të zbatoheshin parimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke marrë për bazë faktin që janë me vite në paraburgim, legjitime do të ishte që të lirohen për t’u gjykuar në liri”, thotë Miftaraj. Por, fundi i gjykatës mund të vijë edhe ndryshe, edhe pa përfunduar procesi gjyqësor.

### A mund të shpërbëhet Gjykata Speciale tani?

I dërguari amerikan për operacione të posaçme, Richard Grenell, ka bërë disa herë thirrje për mbylljen e Gjykatës Speciale. Më 13 prill ai kërkoi ndërprerjen e financimit për Specialet, duke argumentuar se “gjithçka është politikë” dhe se “miliarda janë shpenzuar kot”. Në përvjetorin e pavarësisë së Kosovës këtë vit, ai e quajti

## Çfarë tjetër po hetojnë Dhomat e Specializuara të Kosovës?

Deri më tani kjo gjykatë ka shqiptuar aktgjykime për krime lufte si dhe për pengim të drejtësisë.

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënua me 15 vjet burgim për krime lufte, përfshirë ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje. Për akuzat të ngjashme, ish-pjesëtari i UÇK-së, Pjetër Shala, është dënua me 18 vjet burgim. Ndërsa ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, janë dënua me nga 4 vjet e 3 muaj

burgim për pengim të administrimit të drejtësisë, përfshirë zbulimin e informatave konfidenciale dhe identitetin e dëshmitarëve. Më pas ata janë liruar me kusht.

Në shkurt të këtij viti, Gjykata Speciale i ka shpallur fajtorë edhe Haxhi Shalën, Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin për akuzat për pengim të drejtësisë, më konkretisht frikësim të dëshmitarëve, pas një marrëveshjeje të fajësisë që kanë arritur palët. Shala është dënua me tre vjet burgim, ndërkaq

Bahtijari dhe Januzi me nga dy vjet burgim.

Më 6 dhjetor të vitit 2024 Thaçit i është konfirmuar edhe një aktakuzë e re për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në rastin kryesor gjyqësor.

Përveç Thaçit, në aktakuzën e dytë janë përfshirë edhe emrat e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçit, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakajt, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilajt, dhe Fadil Fazliut.

“padrejtësi të madhe” qëndrimin e Thaçit në Hagë. “Edhe institucionet shtetërore të Kosovës, për shkak të politikës, kanë dështuar që të ndërmarrin veprime të domosdoshme ligjore për t’i dhënë fund kësaj padrejtësie”, ka deklaruar Grenell në X.

Thaçi pati ndërprerë një vizitë të planifikuar për në Uashington, në qershor të vitit 2020 - në mandatin e parë të presidentit amerikan, Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë - pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar u pati dërguar Dhomave të Specializuara në Hagë aktakuzën me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën emri i Thaçit përmendej për një sërë krimesh.

Aktakuzën e kishte ngritur prokurori Jack Smith, i cili më vonë dha dorëheqje për ta hetuar presidentin Trump për përpjekjet për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020. Ai ka dhënë dorëheqje nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë si dhe hetimet ndaj Trumpit kanë pushuar pas fitores së tij në zgjedhjet e vitit 2024.

### Përpjekjet për zhbërjen e gjykatës në Hagë

Në dhjetor të vitit 2017 një grup prej mbi 40 deputetësh të Kuvendit të Kosovës kishin ndërmarrë një nismë për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Kjo nismë ishte kritikuar nga bashkësia ndërkombëtare. Ambasadorët e atëhershëm të ShBA-së dhe Britanisë së Madhe, Greg Delawie dhe Ruairi O’Connell, e kishin quajtur këtë tentim “thikë pas shpine” dhe “natën më të rrezikshme për Kosovën që nga paslufta”.

Pa mbështetje të mjaftueshme në Kuvendin e Kosovës, përpjekja kishte dështuar. Por, nëse ShBA-ja tani do të ndryshonte qëndrim dhe do të shkonte në vijë me kërkesën e Grenellit për mbylljen e Gjykatës Speciale, ajo mund ta dëmtojë rëndë procesin, thotë Miftaraj. “Mundësia që ShBA-ja t’i tërheqë gjyqtarët dhe prokurorët të caktuar në Hagë padyshim që do ta vështirësonte punën e Gjykatës, do ta pengonte vazhdimësinë e procesit, kështu që në njëfarë mënyrë do ta bllokonte atë”, thotë Miftaraj. Megjithatë, ai beson se do të ishte në interesin e të

gjithë sponsoruesve që “ky proces të përfundojë si proces gjyqësor” dhe shton se mundësitë që Gjykata të mbyllet përmes një vendimi politik “janë të vogla”.

Edhe pse Gjykata Speciale është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, ajo financohet kryesisht nga Bashkimi Evropian, me kontribute shtesë nga disa shtete të tjera, si Shtetet e Bashkuara, Kanada, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia.

Kontributi i ShBA-së kryesisht është i përqendruar në financimin e punonjësve të emëruar nga autoritetet shtetërore amerikane.

Sipas raportit të fundit vjetor të Gjykatës për vitin 2023, ShBA-ja renditet e dyta, pas Holandës - shtetit mikpritës të selisë së Gjykatës - sa i përket numrit të punonjësve në Gjykatën Speciale. Tridhjetë nga rreth 280 të punësuarit atje janë nga ShBA-ja. Në mesin e punonjësve amerikanë janë edhe gjykatës dhe prokurorë të specializuar. Nënkryetari i gjykatës është amerikan Charles L. Smith III, ndërkaq kryeprokurore është amerikania Kimberly West, që mori këtë post më 2023. Gjykatësi Smith është edhe gjykatësi kryesor në rastin më të madh të gjykatës, atë

kundër ish-krerëve të UÇK-së. Dhomat dhe Prokuroria e Specializuar aktualisht kanë një buxhet prej 97.1 milionë eurosh, që përfshin periudhën nga 15 qershori i vitit 2023 deri më 14 qershor 2025.

### Pse u formua Gjykata Speciale?

Për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit ishte përfolur për një kohë të gjatë para ngritjes së aktakuzës. Qysh në vitin 2010, ish-senatori zviceran Dick Marty kishte bërë një raport për Këshillin e Evropës, në të cilin kishte dënua krimet e supozuara të UÇK-së, përfshirë “trafikimin e organeve njerëzore”.

Këto pretendime janë hetuar nga prokurori amerikan Clint Williamson, që më 2014 kishte bërë të ditur se gjetjet e ekipit të tij nuk përfshijnë dëshmi të bazuara për trafikim organesh, por për krime të tjera lufte. Kjo, në vitin 2015, kishte çuar në formimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Formimi i Gjykatës Speciale kishte ardhur pas presionit nga bashkësia ndërkombëtare, që besonte se vendosja e gjykatës jashtë Kosovës do të siguronte një proces gjyqësor

të paanshëm dhe të besueshëm për t’i trajtuar akuzat e rënda.

Një tjetër arsye ishte thënë se ishte mbrojtja e dëshmitarëve. Megjithatë, në këtë gjë janë hasur probleme edhe pse Gjykata është vendosur në Hagë.

### Si është pritur Gjykata Speciale në Kosovë?

Më 3 gusht të 2015-s Gjykata Speciale mori votat e mjaftueshme për themelimin pas dështimit më 26 qershor të atij viti.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), deputetë të komuniteteve joshumicë dhe disa deputetë nga Nisma kishin votuar për, duke siguruar 82 vota. Për themelimin nevojiteshin 80 nga 120 votat në Kuvend.

Lëvizja Vetëvendosje, parti që ka qenë në pushtet në mandatin e fundit dhe që fitoi zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt, e kishte kundërshtuar ashpër krijimin e gjykatës, duke e cilësuar të padrejtë ndaj luftës çlirimtare të UÇK-së.

Gjykimi ka hasur në kundërshtime të shumta në Kosovë, me arsyetimin se ky proces është i njëanshëm, pasi në të nuk përfshihen krimet e kryera nga serbët në territorin e Kosovës. Që atëherë nëpër Kosovë janë vendosur pankarte e pllakate të mëdha me mesazhin “Liria ka emër” dhe fotografi të ish-krerëve të UÇK-së që po akuzohen në Hagë. Pak para nisjes së gjyqit në Hagë, protesta kundër këtij procesi ishin zhvilluar edhe në Hagë dhe në Prishtinë. Mijëra qytetarë kishin marrë pjesë në “Marshin për Drejtësi”, të organizuar më 2 prill të 2023-s në Prishtinë, në përkrahje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. “Historia jonë nuk mund të rishkruhet”, “Marshojmë për drejtësi” dhe “Drejtësi jopolitike”, ishin disa nga pankartat që protestuesit mbanin në duar.



## Përkujtohet masakra në rrugën e Kovaçëve në Mitrovicë

**MITROVICË, 14 PRILL** - Në përvjetorin e 26 të masakrës në rrugën e Kovaçëve, qytetarë, përfaqësues institucionalë dhe familjarë të viktimave u mbledhën për ta nderuar kujtimin e 31 shqiptarëve të vrarë nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

Nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorë komunalë, vendosën buqeta me lule dhe bënë homazhe pranë pllakës përkujtimore, ku janë të gdhendur emrat e viktimave të kësaj masakre. "Sot jemi mbledhur këtu për të bërë

homazhe dhe për t'i kujtuar viktimat e masakrës në rrugën e Kovaçëve - një nga plagët më të mëdha të qytetit tonë. Për çdo vit kujtojmë vrasjen e civilëve të pafajshëm në këtë lagje dhe bashkëndiejmë dhimbjen me familjet e tyre", tha nënkryetari Tahiri.



# QEVERIA KURTHI 3 E "BEKUAR" NGA PROF. DR. RAMÇE



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**A po bashkohemi me Shqipërinë apo me Serbinë:** Puna e formimit të qeverisë Kurthi 3 po bëhet si tërkuzë apo si një lindje e vështirë me shumë mami. Thonë se kur ka shumë mami gjatë lindjes, fëmiju lind me të meta. Kështu duket të jetë fati edhe i qeverisë Kurthi 3. KM në mungesë e jo në detyrë, Albin Kurthi, nuk flet fare nëse i ka numrat apo jo, si deklarues në favor të votave i ka nxjerrë personalitetet më të shquara njerëzore, politike, kombëtare dhe intelektuale të LV-së si Halil Thaçi, Dimal Basha, Mef Bajçina, ekstatizë e Prizrenit, si garda pretoriane apo kerberë që e ruajnë derën e hyrjes për në Parajsë e që Kuvendi apo qeveria është parajsë për ta prandaj Kurthin e kanë ZOT, i binden si të ishte vet Zoti. Po t'lemë këta imcakë që kurrë dhe asgjë nuk kanë bërë për Kosovën, shqiptarët, kosovarët e lëre më për Shqipërinë që thuaja e konsiderojnë si vend të huaj në mos edhe armiqësor. Kohëve të fundit kisha një frikë se mund të na sulmojë Shqipëria, për vete isha dorëzuar menjëherë dhe iu kisha bashkuar forcave "okupuese". Ja se na doli një trim i mishleshit që haptazi tha se do të luftonte kundër

Shqipërisë, nëse na sulmon! I besova se fort e pat kundërshtuar Serbinë, deri sa kishte derdhur lot për Xhinxhiqin dhe Ivanoviqin. Kjo vetëm sa e forcon të vërtetën se mençuria e ka një kufi, budallakia nuk njuh dhe nuk ka kufij. Po, pa merak, kjo qeveri asnjëherë nuk do të na vë para dilemave; me Shqipërinë a me Serbinë? Bashkimi me Shqipërinë pamundësohet nga Kushtetuta e Kosovës, për qeverinë Kurthi 2 është Kushtetuta e Ahtisarit kurse bashkimin me Serbinë nuk e pengon as Kushtetuta e Kosovës, as BE e as vendimmarrësit tjerë. Pastaj, deklaratat dhe qëndrimi i qeverisë Kurthi 2 për themeluesit e UÇK-së që e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë dhe e krijuan shtetin, si pikë e ndërmjetme për bashkim kombëtar, nuk dallon aspak nga qëndrimi i Serbisë dhe Rusisë. Një numër i madh i tyre çështjen kombëtare e kanë si mish të huaj në trupin e tyre me përmbajtje dhe bindje jugosllave. Ta marrim Listën e deputetëve të LV-së apo të kabinetit qeveritar. Me respekt për raste të izoluara me një të kaluar kombëtare, aty nuk gjeni asgjë kombëtare, rrinë gatitu për euro para himnit memec të Kosovës, e urrejnë "rreth flamurit të përbashkuar.." kurse në mendje dhe shpirt e kanë "Hej slloveni". Nëse nuk kishin moshë për të luftuar, kishin familje, që nuk kanë histori aspak kombëtare. Përkundrazi! Merrini ministritë vitale për një shtet, më gjeni një të kaluar kombëtare, personale apo familjare. Nuk i gjeni, mos u lodhni!

**A po bëhet qeveria Kurthi 3:** Përfituesit e çastit duan që sa më shpejtë ta formojnë qeverinë Kurthi 3, madje edhe ne 60.51 për qind të votave, vetëm ta ruajnë pronësinë mbi livadhin e quajtur Kosovë ku kanë shkatërruar çdo gjë mbi tokë e sidomos nëntokë. Nuk e kanë problem, as njerëzor e së paku moral nëse prostitucionin politik e përdorin për të siguruar numrat. Nuk e kanë për herë të parë! Për të larguar çdo dyshim nëse janë siguruar numrat për qeverinë Kurthi 3, doli në skenë një tupan i shqyer, në jetën e përditshme i njohur si ndotës mediatic, elefant i mediokritetit dhe injorancës kurse në qarqet "intelektuale", i vetdeklaruar si prof. dr. Ramçe...Kurthi .ov. Partnerin e gjeti te partia që siguron stabilitet dhe siguri afatgjate për Kosovën, rajonin dhe botën...NISMËN, që, sipas meje mund ta ketë pasur qëllimin e mirë në fillim por se do të përfundojë, në të ardhmen në LV sikur mendermethënë Lista Guxo dhe Alternativa kundër veteranëve të UÇK-së e që janë shkruar në Listën e LV-së, duke "ruajtur identitetin..". Fatin e tillë do ta ketë edhe NISMA dhe nuk mund ta paramendoj që Fatmir Limaj të ngjitet me fatonpeca, haxhiqamila apo zemlaken e Radojçiqit, Limoza Kularin. Apo në klounen shëtitëse që paguhet shumë për turpin që e shpërndanë nëpër botë në emër të Kosovës, Donikë Shvarc Zezën. Nëse Fatmir Limaj dhe NISMA vërtetë do të ishin të domosdoshëm për procese politike që e presin Kosovën, nuk do të kishte asnjë problem, do të admiroheshin nga të gjithë. Por, me votat

shumë modeste apo simbolike nuk do të prodhojnë asnjë rezultat përveç se do të luajnë rolin e kalit për ta kaluar lumin qeveria Kurthi 3. E pastaj vjen ajo e famshmja: "e kalova lumin, ta q...sha kalin..". Pastaj, koalicioni parazgjedhor është njëfarë marrëveshje martesore, nuk mund të shkëputet që në ditën e parë, pa ndonjë arsye të madhe! Nëse, pa paralajmërim largoheni nga shtrati martesor - koalicioni, është njëfarë tradhtie, mbani përgjegjësi para Robit dhe Zotit. Hyra pak si thellë! Në anën tjetër e gjejë një arsye të besueshme për bashkim eventuale të Fatmirit me Kurthin e këto janë: Fatmir Limaj e bënë këtë vetëm për çështje kombëtare e jo për poste e lëre më materiale. Fatmir Limaj do t'i bindë këta mahlukatët e LV-së se shteti nuk provohet. Fatmir Limaj bashkë me Besnik Bislimin, Hajnullah Çekon dhe të tjerët do ta luftojnë pa asnjë kompromis korrupsionin. Ky do të jetë misioni kryesor i tij. Malishevën do ta bëjë qytet metropolitan, pa asnjë dyshim! Ky është qëllimi dhe gjykimi i tij. Mund të ketë edhe arsye tjera por që me mungesën e kapacitetit që e kam, nuk i dalloj. Dhe për fund, nëse Fatmiri e lidhë fatin politik me Kurthin dhe Donikë Shvarc Zezën, fundin politik do ta ketë aty, si pjesë e LV-së, sepse askush nuk do të bashkëpunojë me të. Fort jam i bindur se LV-së por as opozitës nuk i duhet qeveria me 61 - 63 vota, nuk vlen për pesë para. Nëpër proceset që do të kalojë Kosova domosdoshmërisht duhet të arrihet një konsensus

kombëtar dhe politik, deri në përfundim të proceseve që, as nuk do të jenë të mira e as të lehta për Kosovën. Pas këtyre proceseve do të shpallëshin zgjedhjet dhe në bazë të votave do të projektohej arkitektura politike dhe qeverisëse. Mos të mendojë se Kurthi me elberta, atiq, damka, surroja etj., dhe duke lënë pa vendimmarrje 49 deputetë shqiptarë (pa Limajn), do të mund të merr vendime të rëndësishme për Kosovën. E njëjta vlen edhe për opozitën e pabashkuar e me një bashkim eventuale, nuk do të mund të martë vendime të rëndësishme për Kosovën duke lënë 48 deputetë të LV-së (pa Limajn) pa vendimmarrje. Prandaj po kërkoj konsensus politik dhe nacional. Për asgjë tjetër. Me respekt, admirim, dashuri dhe përvullim përkujtoj 22-vjetorin e rënies së bardhë për çlirim dhe bashkim kombëtar, Islam Berishën - Komandant Lamin dhe Hamzë Behramin, luftëtarëve të të gjitha luftave Çlirimtare të shqiptarëve, kudo që u bënë. Komandant Lami dhe Hamzë Behrami lirinë dhe bashkimin kombëtar e kishin ideal, frymëmarrje, jetë dhe pikësynim përtej ku nuk shkohej më. Komandant Lamin e kam njohur, e kam pasur mik shtëpie ndërsa Hamzën jo. Por pasi ishte me Lamin, i njëjtë ishte edhe për mua. Komandant Lami dhe Hamzai, nuk patën çka të japin më shumë se që e dhanë, frymën dhe Jetën për të frymuar ne dhe për të jetuar ne, jo për të mbijetuar. A e kemi merituar dhe a e meritojmë sakrificën sublime të Komandant Lamit, Hamzait dhe Heronjve të Kombit. Shumë dyshoj!

## Qeveria në detyrë mban mbledhje elektronike, miraton tri vendime

**PRISHTINË, 14 PRILL** - Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar të hënën mbledhje elektronike në të cilën ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin e qeverisë nr. 06/143 të datës 28.04.2017, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e qeverisë nr. 16/48 të datës 7.12.2020, vendimin nr. 02/54 të datës 12.01.2022 dhe vendimin

nr. 04/70 të datës 21.04. 2022. "Pika 2 e vendimit të cekur më lart zëvendësohet si në vijim: 'Mandati i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës është deri më 15 maj 2028'. Pas pikës 2 të vendimit të cekur më lart shtohet pika 2. a. me tekst si në vijim: 'Afati për ta

parashtruar kërkesën për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës zgjatet deri më 15 maj 2027'. Pika 1.6 e vendimit të qeverisë nr. 16/48 të datës 7.12.2020 zëvendësohet me këtë tekst: 'znj. Kimete Haxholli, udhëheqëse e Divizionit për Përpunim dhe Arkivim në IKKL', ka njoftuar qeveria.



# SUDANI NJEH PAVARËSINË E KOSOVËS

PRISHTINË, 14 PRILL - Sudani, vend në verilindje të Afrikës, e ka njohur pavarësinë e Kosovës të shtunën, ka njoftuar presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Në një njoftim në X, Osmani tha se Kosova dhe Sudani janë pajtuar për të lidhur marrëdhënie diplomatike. "Ky është fillimi i një partneriteti madhështor", shkroi Osmani. Njohja nga Sudani është e dyta brenda javësh për Kosovën, pasi një shtet tjetër afrikan, Kenia, e njohu atë në fund të marsit. Në një video përkrah ministrit të Jashtëm të Sudanit, Ali Yousuf al-Sharif, në Forumin e Diplomacisë në Antalia të Turqisë, Osmani tha se u njoftua nga ai për vendimin e

presidentit të Sudanit për ta njohur Kosovën dhe për të lidhur marrëdhënie mes dy vendeve.

Njohjet nga Kenia dhe Sudani vijnë pas një rënie të ritmit të njohjeve të Kosovës në vitet e fundit. Para tyre, shteti i fundit që e njohu atë ishte Izraeli në vitin 2021.

Sudani është bërë tani shteti i 119-të që e njeh Kosovën, një vendim që pritet ta zemërojë Serbinë, e cila e lufton vazhdimisht pavarësinë e fqinjët të vet.

Serbia e dënoi vendimin e Kenias për ta njohur Kosovën dhe tha se ai mund të ndikojë edhe në marrëdhëniet e Beogradit me shtetin afrikan.



Sudani është duke u përballur me krizën më të madhe humanitare në botë si pasojë e një luftë pothuajse dyvjeçare. Ai është bërë vendi i vetëm afrikan që po përjeton uri ekstreme, sipas Kombeve të Bashkuara. Pothuajse 25 milionë njerëz -

gjysma e popullsisë së Sudanit - përballen me uri ekstreme, ndërsa njerëzit po vdesin në zonat e goditura nga uria në Darfurin Perëndimor, sipas OKB-së. Konflikti në Sudan nisi më 15 prill 2023, kur tensionet e

kamotshme midis udhëheqësve ushtarakë dhe atyre paraushtarakë shpërthyen në kryeqytetin Kartum dhe u përhapën në rajone të tjera, përfshirë zonën e gjerë të Darfurit Perëndimor.

Prej atëherë thuhet se të paktën 20 000 njerëz janë vrarë, megjithëse numri ka mundësi të jetë shumë më i lartë.

Në fund të muajit të kaluar ushtria sudaneze e rimori kontrollin mbi Kartum, një fitore e rëndësishme simbolike në luftë, por grupi paraushtarak rival, Forcat e Mbështetjes së Shpejtë (RSF), vazhdon ta kontrollojë pjesën më të madhe të Darfurit dhe disa zona të tjera.

REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

## KOSOVA, DEPONI E "MBETJEVE NJERËZORE"!

Qeveria e papërgjegjshme e Kosovës përmes ministrisë së papërgjegjshme të Drejtësisë, e nënshkruan një marrëveshje me qeverinë e Danimarkës për trafikim me qenie njerëzore me ç'rast 300 të dënuar nga gjykatat daneze, asnjëri danez do të transferohen në Burgun në Pasjak të Gjilanit për një afat kohorë prej 10 vjetësh. Të dënuarit që do të transferohen në Kosovë kundër vullnetit të tyre janë të dënuar për krime të rënda në Danimarkë dhe kryesisht janë nga Afrika apo shtetet tjera problematike të botës. Danimarka, në pamundësi që t'i resocializojë dhe shkak i politikave raciste ndaj të huajve, po ia shet Kosovës sipas parimit: "çdo gjë 99 cent...". Kosova, si një shtet që ende nuk është liruar nga mendësia kolonialiste të vartësisë ndaj të huajve, këtë marrëveshje e plasoi në opinion si diçka jashtëzakonisht të mirë dhe përfituese, materialisht dhe politikisht. Opinioni u mashtrua nga një ministre mashtruese që i fshehu faktet e vërteta sikur që edhe deputetët të papërgjegjshëm të Kuvendit të Kosovës e votuan këtë



marrëveshje pa e lexuar fare. KMDLNj fuqishëm e kundërshton këtë marrëveshje për faktin se i diskriminon të burgosurit dhe të dënuarit në

Kosovë, e shkatërron Shërbimin Korrektues të Kosovës sikur që nuk ka asnjë mundësi të garantojë të drejtat e njeriut të të burgosurve që po trafikohen

nga Danimarka. Kosova, në saje të një politike të papërgjegjshme po bëhet shkelëse e të drejtave të njeriut si për të dënuarit në Kosovë ashtu edhe ata që do të vendosen dhunshëm në Burgun e Gjilanit, asnjëri shtetas danez, asnjëri i dënuar për vepra të lehta por shumica e tyre të dënuar për krime të rënda dhe përsëritës të veprave kriminale. E keqja nuk përfundon këtu por fillon pikërisht këtu. Tash edhe shtetet tjera, duke e marrë për bazë marrëveshjen kriminale të nënshkruar midis ministres së Drejtësisë së Kosovës dhe ministrit danez, po kërkojnë të lirohen nga të burgosurit duke i transferuar në Kosovë. Belgjika, Austria, Holanda planifikojnë të marrin objekte me qira në Kosovë për t'i transferuar në Kosovë kurse Mbretëria e Bashkuar përmes KM laburist, Starmer planifikon që në Kosovë të dërgojë të burgosur të papërmirësueshëm sikur edhe refugjatë të paligjshëm. Dhe, mund të mos jetë edhe kërkesa e fundit e kësaj natyre, administrata Tramp planifikon të dërgojë në Kosovë refugjatë të

paligjshëm. Po të refuzohej marrëveshja me Danimarkën, sigurisht se Kosova nuk do të tundohej nga propozimet tjera që brutalisht shkelin të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria dhe familjeve të tyre. Po të ishte Kosova anëtare e Këshillit të Evropës, Marrëveshja me Danimarkën do të rrëzohej menjëherë. Kosova duhet t'i refuzojë të gjitha këto kërkesa sikur që duhet të rishqyrtohet Marrëveshja me Danimarkën, si shumë e dëmshme dhe që përligj praktika diskriminuese dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut.

Nuk duhet të lejohet që Kosova të shndërrohet në rezervuar të "mbetjeve njerëzore" e që të tillë i konsiderojnë shtetet që e shantazhojnë Kosovën për të pranuar të dënuar dhe refugjatë të paligjshëm prej të cilëve duan të lirohen shtetet evropiane dhe të tjera. Kosova nuk duhet të lejojë që brenda territorit të saj të zbatohen dy ligje për ekzekutim të sanksioneve penale, ai danez dhe kosovar. Nesër, me "zgerimin e biznesit të pistë..." mund të zbatohen edhe ligje të shteteve tjera.

## Gërvalla takon Kallasin: Koha për vendime të guximshme që përfshijnë Kosovën në BE

PRISHTINË, 14 PRILL - Ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës së Republikës së Kosovës, Donika Gërvalla, ka zhvilluar takim me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Kaja Kallas, në të cilin ka theksuar rolin kyç që ka Bashkimi Evropian jo vetëm për ruajtjen e stabilitetit, por edhe për ofrimin e vizionit dhe drejtësisë për të gjithë qytetarët e Evropës.

Sipas njoftimit për medie, ministria në detyrë nënvizoi nevojën që Republika e

Kosovës të trajtohet partnere e barabartë dhe e respektuar në të gjitha proceset integruuese evropiane, duke përfshirë përshpejtimin e rrugës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në organizata të tjera ndërkombëtare.

"Ajo theksoi se mbështetja për Kosovën nuk mund të mbetet në nivel deklarativ, por duhet të përkthehet në hapa konkretë, përmbylljen e procesit për anëtarësim në Këshillin e Evropës, avancimin e aplikimit për anëtarësim në BE dhe heqjen e masave të padrejta që cenojnë frymën e

partneritetit", thuhet në njoftim.

Gërvalla ritheksoi se e ardhmja evropiane e Ballkanit Perëndimor nuk mund të jetë e plotë pa Kosovën. "Mbështetja për Republikën e Kosovës është një mbështetje për një Evropë më demokratike, më të barabartë dhe më të bashkuar", ka deklaruar Gërvalla.

Gërvalla ka bërë me dije se prania dhe angazhimi i Kosovës në rajon është një burim i fuqishëm i stabilitetit dhe sigurisë për të gjithë kontinentin. Në këtë drejtim, ministria në detyrë ka thënë



se tani është koha për vendime të guximshme dhe për një vizion të përbashkët

evropian që përfshin edhe Kosovën si pjesë të natyrshme të tij.

# BLERJET ONLINE NË KOSOVË: KUR ÇMIMI I LIRË KUSHTON SHUMË


PRISHTINË, 14 PRILL - Mediet sociale janë bërë treg në Kosovë, por jo të gjithë shitësit janë korrektë. Shumë blerës përfundojnë me produkte false ose me cilësi të ulët dhe pa asnjë mënyrë për t'i kthyer prapa paratë e tyre. Ato që dikur shërbenin kryesisht si hapësirë për t'u lidhur me miqtë, tani janë shndërruar edhe në pazar digjital. Përdorues të panumërt të medieve sociale në Kosovë i nxjerrin produktet e tyre online, pa ndonjë rregullore, garanci apo përgjegjësi. Për pasojë, ndodh shpesh që blerësit e tyre marrin diçka tjetër nga ajo që shohin. "Bluzat nuk kishin as ngjyrën, as materialin, as modelin e as madhësinë si në fotografi", tregon për "Radion Evropa e Lirë" një blerës që identifikohet vetëm si Arbeni.

I joshur nga reklama e bukur dhe çmimi i volitshëm, Arbeni thotë se bleu dy bluza. Por, kur pranoi pakon, u ndje i zhgënjyer. "Dallimi ishte jashtëzakonisht i madh me fotografitë", thotë ai. Arbeni tregon se ka kontaktuar disa herë faqen në "Facebook" prej nga ka pranuar porosinë, por nuk ka marrë përgjigje.

Përmes mesazheve online, atë e kontaktoi edhe "Radio Evropa e Lirë", për ta pyetur për adresën e dyqanit, por njësoj - pa përgjigje.

Faqja ka mbi 20 mijë ndjekës dhe asnjë adresë apo numër telefoni. "Të gjitha produktet janë 100 % si në fotografi", shkruan në përshkrimin që ka.

"REL"-i kontaktoi edhe postën që i ka dorëzuar porosinë Arbenit, por përfaqësuesit e saj thanë se nuk kanë të drejtë të ndajnë informacione për shitësit dhe se janë përgjegjës vetëm për shpërndarjen.



Ky rast nuk është i izoluar. Në Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë (MINT) të Kosovës konfirmojnë për "Radion Evropa e Lirë" se nga 1 janari deri më 13 mars të këtij viti kanë pranuar 104 ankesa për kategorinë "blerje online".

Gjatë vitit të kaluar, ndërkaq, kjo ministri ka pranuar 363 ankesa ndaj operatorëve që veprojnë në tregjet elektronike, shumica prej të cilave kanë pasur të bëjnë me moskthimin e mallit.

## Si inspektohen faqet online?

Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, që funksionon në kuadër të MINT-it, është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen e shitjeve online. Megjithatë, autoritetet pranojnë

se kontrolli i faqeve online është i vështirë, pasi inspektorët nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në ambientet ku operojnë këto biznese. "Anonimiteti i shitësve, përdorimi i shumë platformave dhe fshehja e identitetit, duke përdorur faqe dhe emra të remë, si dhe adresa të pasakta, pamundëson inspektimin dhe ndjekjen ligjore të këtyre subjekteve", thuhet në përgjigjen e Inspektoratit dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Për shkak të këtyre sfidave, Inspektorati thotë se i përcjell ankesat e qytetarëve te Policia e Kosovës. Por, kjo e fundit nuk dha ndonjë informacion për masat e marra për ndalimin e këtyre praktikave.

## Thirrje për kujdes

Si Inspektorati ashtu edhe

ekspertët e rrjeteve sociale u bëjnë thirrje konsumatorëve të jenë të kujdesshëm gjatë blerjeve online, pasi ekziston rreziku i mashtrimeve, sidomos sa i përket cilësisë së produkteve.

Para se të kryejnë një blerje, ata i këshillojnë konsumatorët të verifikojnë besueshmërinë e shitësit, duke kontrolluar identitetin e tij, adresën fizike, numrin e telefonit dhe regjistrimin në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK).

Eksperti i rrjeteve sociale, Dardan Hasku, thotë se pagesa nuk duhet të kryhet përpara se të verifikohet produkti. "E mira e gjithë kësaj është se pagesat nuk bëhen me kartelë bankare, por me para në dorë, pas pranimit të produktit. Klientët mund të kërkojnë nga posta që

t'u lejojë të shohin produktin para se të paguajnë. Nëse produkti nuk përputhet me porosinë, ata kanë të drejtë ta refuzojnë", thotë Hasku për "Radion Evropa e Lirë".

Për të rritur vetëdijen mbi rreziqet e blerjeve online, MINT ka shpërndarë disa materiale informuese për konsumatorët. "Gjatë pranimit të mallit, mos paguani pa e hapur pakon për t'u siguruar se po merrni produktin e porositur. Gjithashtu, kërkonti që pagesa të shoqërohet me kupon fiskal", thuhet në një broshurë të MINT-it. "Radio Evropa e Lirë" pyeti Administratën Tatimore të Kosovës nëse këto biznese paguajnë tatim dhe nëse inspektohen, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje.

Sipas ligjeve në fuqi, çdo shitës online është i detyruar t'i dërgojë klientit kuponin fiskal, së bashku me produktin.

Vlerësohet se blerjet online në Kosovë kanë marrë hov nga shpërthimi i pandemisë Covid-19, më 2020, e kënde. Por, blerjet e tilla janë bërë gjithnjë e më shumë pjesë integrale e jetës së përditshme kudo në botë.

Në vitin 2023, në Bashkimin Evropian, 75% e përdoruesve të internetit të moshës 16 deri në 74 vjeç kanë blerë mallra ose shërbime në internet.

Statistikat tregojnë se aksionet e blerësve elektronikë janë rritur nga 53 % më 2010 në 75 % më 2023.

Konsumatorët online në BE kanë disa të drejta, përfshirë të drejtën për informacion të qartë për produktin ose shërbimin, të drejtën për anulimin e blerjes brenda 14 ditësh dhe të drejtën e rimbursimit.

## KOSOVA PËRFITON PESË MILIONË EURO GRANT NGA BERZH-i

PRISHTINË, 14 PRILL - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka nënshkruar të hënën marrëveshjen e grantit në vlerë prej pesë milionë eurosh, së bashku me drejtorin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Sergiy Maslichenko, dhe përfaqësuesin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica", Bashkim Kurti.

Ky grant është pjesë e projektit për zhvillimin e infrastrukturës së ujërave të zeza në rajonin e Mitrovicës dhe parasheh ndërtimin e një impianti modern për trajtimin e ujërave të zeza, si dhe rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues në komunën e Mitrovicës dhe të Vushtrisë, përfshirë edhe zonat

përreth.

Projekti do t'i përmirësojë ndjeshëm kushtet e jetesës për rreth 123 000 banorë të kësaj zone, duke reduktuar ndjeshëm ndotjen mjedisore dhe duke kontribuar në mbrojtjen e burimeve ujore lokale nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara.

Deri më tani vlera e financimit për këtë projekt arrin rreth 38 milionë euro. Granti prej 5 milionë eurosh është siguruar si rezultat i aplikimit të suksesshëm të Kosovës në Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Kjo marrëveshje është dëshmi e përkushtimit për zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit dhe garantim të shërbimeve cilësore për qytetarët.





# HISTORIA E GRABITJES SË MADHE TË TRENIT

Nga: Myles BURKE / BBC

Më 16 prill 1964, Robert Welch ishte një nga 12 burrat e shpallur fajtorë, për një grabitje famëkeqe, në Gjykatën e Kurorës në Ejsbëri. Katërmbëdhjetë vjet më vonë, në vitin 1978, ai u shfaq në programin dokumentar të temave aktuale të BBC-së, Man Alive, ku kujtoi sesi personalitetet lokale përlësheshin për vende në sallën e gjyqit, për të ndjekur shpalljen e dënimeve. “Kjo ishte ajo për çfarë kishin ardhur të gjithë. Kulmi i shfaqjes, drama”, tha Welch. “Dhe, ambienti mesjetar ku u shqiptuan dënimet ... e kupton, ishte paksa tronditës”.

Kishte kaluar një kohë kur Welch dhe miqtë e tij të dënuar kishin realizuar një nga vjedhjet më të guximshme dhe më fitimprurëse që kishte parë ndonjëherë Mbretëria e Bashkuar: Grabitja e Madhe të Trenit.

Welch dhe të tjerët ishin pjesë e një bande që kishte ndaluar një tren të natës së Postës Mbretërore, që udhëtonte nga Glasgow drejt Londrës. Grabitësit ishin larguar me 2.6 milionë paundë në kartëmonedha të përdorura – një shumë rekorde në atë kohë – që sot do të ishin më shumë se 50 milionë paund (rreth 58 milionë euro). Në kohën e gjyqit të Welchit, policia ende ishte në kërkim të tre personave që dyshoheshin se kishin marrë pjesë në krim.

Për të realizuar këtë grabitje të organizuar me kujdes, 15 anëtarë të dy prej bandave më të mëdha kriminale të Londrës kishin bashkëpunuar, secili me një rol të caktuar në plan. “Ata konsideroheshin si elita e botës kriminale”, tha Reginald Abbiss, një gazetar i ri në atë kohë që mbuloi krimin për BBC-në, në podkastin Witness History në vitin 2023. “Duhej të kishe një talent të caktuar, guxim, aftësi të veçanta për të realizuar një grabitje të kësaj përmase – dhe ata u bashkuan sepse duhej një shumëllojshmëri e madhe talentesh”.

Grabitja e guximshme ndodhi pak pas orës tre të mëngjesit të 8 gushtit 1963. Hapi i parë që ndërmorën grabitësit ishte prerja e linjave telefonike për të penguar dhënien e alarmit. Më pas, manipuluan sinjalet e trenit që të qëndronin në të kuqe. “Ata vendosën një dorezë mbi dritën e gjelbër, lidhën një bateri të lirë me dritën e kuqe dhe kjo, natyrisht, bëri që makinisti të ngadalësonte”, tha Abbiss.

Duke parë dritën e kuqe, makinisti i trenit, Jack Mills, ndaloi lokomotivën, ndërsa ndihmësi i tij, David Whitby, zbriti për të përdorur telefonin

anësor të linjës për të kuptuar se çfarë po ndodhte. Aty zbuloi se linja telefonike ishte prerë, dhe menjëherë u sulmua nga burrat me maska dhe të veshur me rroba punëtori. Ndërkohë, një grabitës i maskuar hyri në kabinën e trenit për të neutralizuar makinistin. Kur Mills tentoi të rezistonte, një tjetër anëtar i bandës e goditi në kokë, duke e lënë të pavetëdijshëm.

“E vetmja pengesë, nëse mund ta quajmë kështu, ishte fakti që makinisti i trenit ... tentoi të rezistonte”, tha Abbiss. “Njëri prej grabitësve e goditi në kokë me shkop gome. U derdh shumë gjak dhe ai ra menjëherë”.

Banda kishte marrë informacion të brendshëm se paratë dhe pakot me vlerë të lartë ndodheshin në dy vagonët e parë të trenit. Dhe, për shkak se ishte fundjavë me festë zyrtare (bankat ishin mbyllur), treni do të transportonte më shumë para se zakonisht.

Edhe pse nuk kishte policë në bord, në tren ndodheshin më shumë se 70 punonjës të Postës Mbretërore, kryesisht në vagonët e pasmë, ku ishin të zënë duke klasifikuar letrat. Kriminelët, të cilët tashmë ishin njohur me funksionimin e trenit, shpejt shkëputën dy vagonët ku ndodheshin paratë. Plani ishte t'i ndanin ata nga pjesa tjetër e trenit dhe t'i lëviznin larg një shpatine të pjerrët, drejt një pike të caktuar takimi, ku do të ishte më e lehtë për të shkarkuar thasët me para. Aty hasën në një problem. “Ata kishin një shofer për të drejtuar trenin, por ai nuk arriti ta niste, kështu që u desh ta tërhiqnin nga dyshemeja makinistin fillestar, Jack Mills, dhe ta kërcënonin duke i thënë: ‘Drejto trenin’, tha Abbiss. ‘Ai arriti ta çonte trenin një milje [1.6 kilometra] më tej, deri te vendi ku po prisnin shumica e anëtarëve të bandës, duke lënë pas tetë a nëntë vagonët e tjerë me klasifikues që punonin të qetë, krejtësisht të pavetëdijshëm që pjesa kryesore e trenit kishte vazhduar përpara”.

Mills, ende i gjakosur, u urdhërua të ndalonte dy vagonët e parë në urën Bridego. Aty, pjesa tjetër e bandës hapi me forcë vagonët, neutralizoi stafin e Postës që punonte brenda tyre dhe i detyroi të shtriheshin me fytyrë nga toka. Po ashtu, sollën edhe Millsin dhe Whitbyn, të cilët i lidhën me pranga bashkë. Banda kishte vendosur që t'i jepnin vetes vetëm 15 minuta për të shkarkuar paratë, dhe më pas të linin gjithçka që mbetej. Ata formuan një zinxhir njerëzor dhe me shpejtësi transferuan 120 thasë që përmbanin dy ton e gjysmë para në Land Rover-ët e parkuar. Pas një çerek ore, ekipi dha urdhrin për t'u larguar dhe u



kërkuan punonjësve të Postës që të qëndronin pa lëvizur dhe të mos lajmëronin policinë për të paktën 30 minuta. Më pas, grabitësit u zhdukën në errësirën e natës.

Guximi i grabitjes dhe shuma e madhe e përfshirë e magjepsën publikun britanik. Në javët që pasuan, vendi u përfshi nga titujt sensacionalë që përshkruanin ndjekjen e autorëve nga policia. Por, përkundër planifikimit të përpiktë dhe ekzekutimit të saktë të grabitjes, brenda një viti shumica e bandës kriminale ishte arrestuar dhe përballë me drejtësinë.

“Në shikim të parë, puna dukej si një operacion i planifikuar mirë”, tha për BBC News në vitin 1964, detektivi mbikëqyrës, Malcolm Fewtrell, i cili udhëhoqi hetimet për grabitjen. “Por, në praktikë, rezultoi një katastrofë. Qartazi nuk ishin aq të zgjuar sa mendonin se ishin”. Gjyqtari në procesin kundër tyre nuk i pa veprimet e grabitësve në mënyrën “romantike” si disa pjesëtarë të publikut, duke deklaruar se do të ishte “ligësi” po të tregonte ndonjë shenjë lehtësimi ndaj të dënuarve.

“Mbah mend se si një valë tronditjeje përshkoi sallën e gjyqit kur gjyqtari, një burrë i quajtur Lord Justice Edmund Davies, shpalli 307 vjet dënime brenda gjysmë ore”, tha Abbiss për BBC Witness History në vitin 2023. Në atë kohë, dënimet që morën për grabitjen ishin ndër më të rëndat në historinë kriminale britanike – veçanërisht duke pasur parasysh se askush nuk u vra dhe nuk u përdorën armët e zjarrit.

“Isha i mpirë, nuk mund të mendoja për asgjë tjetër përveç 30 vjetëve. Kur do të dalim? Nuk do të dalim kurrë”, tha njëri nga grabitësit, Tommy Wisbey, për emisionin Man Alive në vitin 1978.

“Nuk mendoj se të bie realisht në mendje, deri disa ditë më vonë, kur e kupton se çfarë

dënimi ke marrë”, i tha BBC-së bashkëpunëtori i tij në bandë, Gordon Goody. “Po, bënim humor ... Por, në thelb, besoj se ishim të sëmurë nga brenda”.

Arsyeja që gjyqtari dha për ashpërsinë e dënimeve ishte sulmi ndaj makinistit Mills. “Kushdo që ka parë atë makinist të tronditur nga nervat, nuk ka asnjë dyshim për efektin tmerrues që ka një sulm i organizuar nga grabitës të armatosur ndaj qytetarëve që respektojnë ligjin”, tha gjyqtari Edmund Davies gjatë gjyqit. Mills nuk punoi më kurrë më dhe vdiq në vitin 1970 nga leukemia. Ndihmësi i tij, Whitby, vdiq nga një atak kardiak vitin pasues, në moshën 34-vjeçare.

Megjithatë, mes vetë grabitësve ekzistonte ndjenja se po ndëshkoheshin në mënyrë të tepruar, sepse grabitja kishte turpëruar shtetin britanik. Njëri prej tyre, Roy James, i tha BBC-së në vitin 1978: “Në atë moment, gjithë turpi që kisha ndier gjatë gjyqit, u zhdok, sepse ndjeva se z. Edmund Davies përdori pozicionin e tij si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, përdori shtetin për hakmarrje. Ai e vendosi veten në të njëjtin nivel me mua dhe gjithçka që më akuzonte se isha”.



“Ekzistonte ndjenja se gjyqtari Davies ra poshtë për dy arsye”, tha Reginald Abbiss. “E para ishte dhuna ndaj makinistit të trenit, dhe e dyta, fakti që shteti – qeveria, Posta Mbretërore dhe Hekurudhat Britanike – u zunë në befasi. U pa se institucioni nuk ishte aq vigjilent sa duhet”. Nami i keq i kriminelëve u rrit edhe më shumë pas dënimit, kur dy anëtarë bënë arratisje spektakolare nga burgju. Charles Wilson, që kishte qenë arkëtar i grupit, u arratis nga burgju vetëm katër muaj pas gjyqit. U kap në Kanada pas katër vitesh në arrati dhe vuajti edhe 10 vjet të tjera në burg. Ronnie Biggs u arratis nga burgju Uandsuorth në Londër, 15 muaj pas dënimit,

duke përdorur një shkallë të improvizuar me litar. Ai kreu operacione plastike dhe jetoi në Spanjë, Australi dhe Brazil, duke iu shmangur arrestimit për gati 40 vjet. Në vitin 2001, u kthye vullnetarisht në Mbretërinë e Bashkuar për trajtim mjekësor dhe vuajti pjesën e mbetur të dënimit.

Ligji në fund arriti edhe te tre anëtarë të bandës që nuk kishin dalë fillimisht në gjyq. Bruce Reynolds, i konsideruar si truri i grabitjes, kaloi pesë vjet në arrati derisa u arrestua pas rikthimit në Angli. U dënua me 25 vjet burg, por në fund vuajti vetëm 10. Djali i tij, Nick, që kaloi fëmijërinë në arrati me të atin në Meksikë dhe Kanada, kishte më vonë një lidhje simbolike me jetën jashtë ligjit, kur kënga e grupit të tij, Alabama 3, Zgjohesh në mëngjes [Woke Up This Morning], u bë kënga hapëse e serialit Sopranot [The Sopranos].

Ronald “Buster” Edwards, i cili më vonë u luajt nga këngëtar i Genesis, Phil Collins, në filmin Bastër [Buster, 1988], iku në Meksikë pas grabitjes. U dorëzua në vitin 1966 dhe u lirua pasi vuajti nëntë vjet burg. James White, që kishte shërbyer si përgjegjës për furnizimet gjatë grabitjes, u kap në Kent dhe u burgos pas tre vitesh në arrati. U lirua në vitin 1975.

Pavarësisht dënimeve të gjata me burg që iu dhanë, të gjithë burrat e dënuar për Grabitjen e Madhe të Trenit përfunduan duke u liruar më herët. Asnjëri prej tyre nuk vuajti më shumë se 13 vjet për këtë krim – megjithëse shumë prej tyre u rikthyen në burg për vepra të tjera penale në vitet që pasuan. Sa i përket shumës së madhe të grabitur gjatë grabitjes, pavarësisht se policia në vitin 1964 ofroi 10 për qind të shumës si shpërblim për informacionin që do t'i çonte tek ato, shumica e parave nuk u gjet kurrë. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Dukagjini dhe Suhareka kërkojnë këndelljen

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 14 prill - Me ndeshjen në mes të Dukagjinit dhe Suharekës do të hapet java e 29 në Superligën e Kosovës në futboll. Kjo ndeshje është paraparë të zhvillohet sot (e martë) nga ora 15:00 në Klinë. Këto dy skuadra në ndeshjet e fundit kanë pësuar debakël nga Ballkani dhe Prishtina, duke humbur me rezultate 0-5 dhe 0-4, kurse tash synojnë të këndellen.

Dukagjini i Ismet Munishit ka grumbulluar 38 pikë dhe në këtë përballje synon fitore për t'i shtuar edhe me shumë shanset për mbijetesë, kurse në anën tjetër Suhareka që është e parafundit dhe ka tri pikë më pak dhe



do të mundohet të shënojë fitore, por mund të jetë e kënaqur edhe me një barazim.

Dy ndeshje të tjera të kësaj xhiroje zhvillohen nesër (e mërkurë) dhe takohen Llapi-Feronikeli '74 dhe Ferizaj-Malisheva. Llapi pas fitores ndaj Gjilanit synon tri pikët e radhës në mënyrë që të largohet sa më shumë nga pjesa e poshtme e tabelës, kurse

"Nikli", që është i fundit, do të luajë pa ndonjë presion. Në ndeshjen tjetër Ferizaj e pret Malishevën. Të dyja këto skuadra kanë shënuar fitore në ndeshjet e fundit dhe të njëjtën gjë synojnë ta bëjnë edhe në këtë xhiro. Dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro zhvillohen ditën e enjte derisa takohen Ballkani - Gjilani dhe derbi Drita - Prishtina.

## SUPERLIGA - Java e 29

Të martën takohen:  
15:00 Dukagjini - Suhareka

Të mërkurën takohen:  
15:00 Llapi - Feronikeli '74  
15:00 Ferizaj - Malisheva

Të enjten takohen:  
15:00 Ballkani - Gjilani  
15:00 Drita - Prishtina

# 'Ylli i javës', Tahiri: Synojmë daljen në garat evropiane

PODUJEVË, 14 PRILL (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 28 i është dhënë sulmuesit të KF Llapit, Ardit Tahirit. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Enver Prapashticës, Milaim Humollit dhe Isuf Llumnicës. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e njëzet e tetë t'i takojë Ardit Tahirit, i cili shënoi dy gola në fitoren 2:3 të Llapit në ndeshjen e rëndësishme kundër SC Gjilani. Pasi mori këtë çmim, Tahiri u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Ishte një ndeshje shumë e vështirë. Jemi përgatitur maksimalisht që të dalim me pikë të plota dhe ia arritëm. Ishte një ndeshje e luftuar nga lojtarët deri në fund. Treguam që kemi shumë karakter brenda ekipit dhe u shpërblyem me tri pikë. Forma ime nuk do të vinte në pah nëse ekipi nuk do të funksiononte mirë - kjo është falë bashkëlojtarëve". "Qëllimi ynë është t'i fitojmë të gjitha ndeshjet e fundit dhe të dalim në garat evropiane, qoftë përmes Kupës apo përmes Ligës, pasi gjasat i kemi. Por qëllimi kryesor mbetet Kupa e Kosovës. Të shpallësh më i miri i



xhiros është ndjenjë shumë e mirë, pasi kjo ka shije edhe më të mirë kur fiton. Falënderoj bashkëlojtarët dhe

familjen time për përkrahjen!", ka deklaruar Tahiri për faqen zyrtare të FFK-së.

## SHKURT

### Batatina arrin kuotën e 200 fitoreve me Llapin

PODUJEVË, 14 PRILL - Trajneri Tahir Batatina ka shënuar sukses të madh me klubin e Llapit, pasi ka regjistruar fitoren e 200. Këtë sukses strategu llapjan e arriti në fitoren 3-2 kundër Gjilanit.

"Kryetrajneri ynë, Tahir Batatina, ka shënuar një arritje historike - fitoren e 200-të si trajner i KF Llapit! Këtë moment të veçantë e shënuam sot gjatë stërvitjes së mëngjesit me një befasi simbolike, duke e vlerësuar kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për klubin tash e 12 vjet. Urime kryetrajner, Tahir Batatina!", thuhet në postimin e Llapit.

### Shaqiri dhe Rrudhani në formacionin e javës në Zvicër

Ka vazhduar shkëlqimi i Xherdan Shaqirit dhe Donat Rrudhanit me skuadrat e tyre në Superligën e Zvicrës. Dy futbollistët nga Kosova kanë lënë gjurmë këtë javë në Zvicër me gola dhe asistime. Shaqiri ishte fantastik në fitoren e Baselit 0-4 në udhëtim te Zurichu duke shënuar dy gola. Ndërkohë reprezentuesi nga Kosova, Donat Rrudhani, ishte i pandalshëm për Luzernin, pasi fitoi 5-0 ndaj Young Boys Bernit. Në këtë sfidë Rrudhani ishte më i miri në fushë duke shënuar një gol dhe duke asistuar në një tjetër. Të dy futbollistët nga Kosova kanë zënë vend në formacionin e javës në Zvicër.

### Gjimshiti: Tifozët mezi e presin ndeshjen ndaj Serbisë

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, ka dhënë një intervistë në podcastin e Heidi Lushtakut, që është edhe bashkëshortja e Merih Demiral, ish-shokut të skuadrës së mbrojtësit. Kapiteni ka thënë se tifozët mezi e presin këtë ndeshje, por nuk do të ketë asnjë rrezik. "Shpresoj që jo. Në luajmë futboll dhe nuk duhet të përzihemi me politikën. Futbollit është diçka që ndiqet më shumë në të gjithë botën. Sa i përket asaj ndeshjeje, kur ka qenë shorti i grupeve, nuk kam qenë i lumtur sepse më janë kujtuar ato që kanë ndodhur më 2014. Sigurisht që kam menduar: Jo, jo, mos prapë! Por, tani që ka kaluar edhe kohë, është zhvilluar edhe futbollit në Shqipëri dhe tifozët mezi e presin atë ndeshje, por nuk do të jetë ndonjë rrezik. Do të merren masat dhe do të luajmë vetëm futboll. Shpresojmë!", ka thënë Gjimshiti.

## Daku shënon golin më të bukur të muajit në Rusi

**KAZAN, 14 PRILL** - Jo më kot thonë se ai është gjysma e skuadrës. Mirlind Daku vazhdon të jetë protagonist për Rubinin në Premierë Ligën ruse, edhe i dëmtuar, ndërsa përpara ndeshjes së fundit mori një çmim. Sulmuesi i kombëtares shqiptare u vlerësua nga

organizatorët e kampionatit në Rusi si autori i golit më të bukur të muajit mars. Pavarësisht prej lëndimeve që nuk e kanë lënë të qetë, Daku realizoi muajin e kaluar dy gola kundër Spartakut të Moskës, duke u shpallur lojtari më i mirë i ndeshjes. Siç njofton faqja zyrtare e Premierë

Ligës ruse, Daku është shpallur katër herë këtë sezon futbollisti më i mirë i ndeshjes. Rubini arriti një tjetër fitore me 27-vjeçarin që nga minuta e parë, ndonëse 1-0 kundër Lokomotivës moskovite, edhe pse nuk ishte autor goli. Rrjetën e vetme e realizoi një tjetër

lojtar me origjinë shqiptare nga Kosova, Dardan Shabanxhaj, në minutën e 50. Shabanxhaj, që përfaqëson Austrinë si kombëtare, u shpall edhe lojtari më i mirë i ndeshjes, ndërsa Daku e përqafoi fort dhe i kujtoi se i kishte thënë përpara ndeshjes se do të shënonte.



## 'Vreshtarët' inkuadrohen në Superligë

**RAHOVEC, 14 PRILL** - Grapeland është kampion i Ligës së Parë dhe do të jetë anëtar i ProCredit Superligës për edicionin e ardhshëm. Në ndeshjen e tretë finale të "play-off"-it shënoi fitore ndaj KEK-ut me rezultat 75:69 (20:13, 18:20, 16:17, 21:19).

Të përkrahur nga tifozët vendas, "Vreshtarët" e nisën ndeshjen më mirë, duke qenë në epërsi konstante në çerekun e parë, 20:13. Megjithatë, "Elektricitet" u rikthyen shpejt për t'i përmbysur shifrat në 27:28, e më pas u zhvillua lojë interesante, ku vendasit shkuan në pushim me rezultat 38:33. Në pjesën e dytë, sidomos në çastet vendimtare, më të mirë u treguan vendasit, që arritën fitore të madhe, duke u shpallur kampionë dhe duke siguruar hyrjen në Superligë edicionin e ardhshëm. Ndërkohë, KEK-u do



të luajë me Borën në "play-out" për një vend në elitë edicionin e ardhshëm. Medaljet e arta dhe të argjendta, si dhe trofeun e Kupës e dhanë anëtarët i Bordit të FBK-së, Rahman Përteshi dhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi. MVP i

finalës së Ligës së Parë ndërmjet Grapeland dhe KEK-ut u shpall Bardh Rexha i Grapelandit, i cili e mbylli ndeshjen me 20 pikë e 11 kërcime, çmim të cilin e dha Rahman Përteshi, anëtar i Bordit të FBK-së.

## Hamiltoni: Nuk e kisha imagjinuar që gjërat me Ferrarin do të shkonin kaq keq në fillim

**MANAMA, 14 PRILL** - Edhe pse dy pilotët e Ferrarit u renditën në vendet 4-5 në garën e fundit zhvilluar në Bahrein, ky nuk ishte rezultati që te "kokëkuqja" shpresonin si në këtë garë ashtu dhe në këtë fillimsezon. Ata sollën disa risi në Bahrein, përdorën një strategji ndryshe nga rivalët, por kjo nuk mjaftoi.

Piloti britanik Lewis Hamilton, shtatë herë kampion bote në Formula 1, ka deklaruar: "Nuk e prisja që të shkonte aq keq ky start i sezonit. Nuk e mendoja se performanca ime do të ishte kështu dhe se aftësia ime për t'u përshtatur me këtë makinë do të ishte aq e keqe sa ishte në të vërtetë". "Unë nuk heq dorë, por duhet të përipiqem t'i afrohem edhe më shumë këtij potenciali që ka makina. Unë kam pilotuar në një stil të



caktuar, në një mënyrë të caktuar dhe me të njëjtin ekip për një kohë të gjatë. Kam kaluar në një makinë të re që

kërkon një stil të ndryshëm drejtimi dhe cilësime të ndryshme", ka shtuar Hamiltoni. "Kjo makinë kërkon një stil drejtimi shumë, shumë të ndryshëm, ndaj po përshtatem. Po vendos ngadalë disa gjëra në kokën time për ta gjetur ekuilibrin e duhur, por është e qartë se Charles fillon me një set-up dhe e mban atë praktikisht për të gjithë fundjavën, ndërsa unë jam shumë larg prej tij. Javën tjetër do të përipiqem të filloj nga një vend më i mirë dhe të mos ndryshoj shumë nga ajo bazë. Siç thashë, mendoj se kam mësuar se si dëshiron të drejtohet makina dhe shpresoj t'i zbatoj ato mësimet fundjavën e ardhshme. Nëse mund të kualifikohem më mirë, mund të kem një rezultat shumë më të mirë", ka pohuar Hamiltoni.

### SHKURT

#### Mbyllet sezoni i rregullt në NBA

Është mbyllur sezoni i rregullt në NBA për sezonin sportiv 2024-2025 dhe skuadrat përgatiten për fazën "play-off". Gjashtë ekipet e para të secilës konferencë kalojnë direkt në fazën "play-off". Ndërsa skuadrat e renditura në vendet 7-10 do të luajnë në fazën "play-in", një fazë shtesë që do t'i përcaktojë dy çerekfinalistët e fundit. Luhet me ndeshje të vetme, në fushën e renditur më mirë në sezonin e rregullt. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 15 prill. Oklahoma, me 68 fitore e 14 humbje, është skuadra më e mirë në NBA, ndërsa në Konferencën e Lindjes ekipi me rezultatin më të mirë është Clevelandi (64 fitore e 18 humbje).

#### Slot: Për titull na duhen edhe dy fitore

Pavarësisht se Liverpools e ka prekur titullin me një dorë, trajneri Arne Slot nuk feston përpara kohe. Ai ka thënë se për të arritur këtë sukses të madh, skuadrës i duhen edhe dy fitore. "Në këto 33 ndeshje është parë se sa e vështirë ka qenë për ne fitorja, duket pak e çuditshme pasi kemi një diferencë të madhe pikësh me rivalët. Tani e dimë se për ta fituar titullin na nevojiten vetëm dy fitore. E dimë që nuk do të jetë e lehtë, por ne do ta provojmë me të gjithë forcat tona", u shpreh Slot.

#### Mulleri: Interi festoi para kohe, ka edhe 90 minuta

Bayern Muncheni do të udhëtojë në Milano me një mision të vështirë, ta përmbysë disavantazhin 1-2 ndaj Interit të ndeshjes së parë çerekfinale të Ligës së Kampionëve. I bindur se skuadra bavareze mund t'ia dalë mbanë është sulmuesi veteran Thomas Muller. "Ata festuan sikur të kishin kaluar turin, por ka ende 90 minuta për të luajtur dhe vetëm një gol për të shënuar. Kualifikimi nuk është një ëndërr. Unë kam një mendim të kundërt për përkufizimin që i jepet ndeshjes të së mërkurës. Nuk do të duhet një mrekulli", ka thënë Mulleri. "Fitorja jashtë fushe për Bayernin nuk është tabu. Duhet një lojë e mirë, duke kujtuar se një fitore me një gol do të na dërgonte të paktën në kohën shtesë. Ne mund të shënojmë. Jemi të praktikshëm dhe mund ta shfrytëzojmë këtë në favorin tonë", ka shtuar Mulleri.

#### Modriqi pritet të largohet nga Reali

Luka Modriqi mund të largohet pa pagesë nga Real Madridi në qershor 2025 pas 13 viteve qëndrim. Kontrata e tij do të skadojë dhe, sipas "Diario AS", nuk ka marrëveshje për rinovimin e saj. 39-vjeçari ka luajtur një rol kyç në klub prej vitesh, por Real Madridi tani po planifikon për të ardhmen. Lojtarët më të rinj kanë filluar të marrin më shumë hapësirë në skuadër dhe klubi mund të vendosë të mos i ofrojë kroatit një marrëveshje të re. E ardhmja e Modriqit është e pasigurt. Ai mbetet një nga mesfushorët më të mirë në botë, por kontrata e tij skadon në vitin 2025 dhe ende nuk ka një marrëveshje për rinovimin. Klubi po mendon ta lërë të shkojë falas nëse nuk arrihet marrëveshje. Është një vendim i ndikuar nga nevoja për ta rifreskuar ekipin me lojtarë më të rinj. Lëvizja e radhës e Modriqit nuk është konfirmuar, por trashëgimia e tij te Real Madridi tashmë është e siguruar.

## Mbappe u kërkon falje të gjithëve pas kartonit të kuq

Kylian Mbappe mori karton të kuq për një goditje të fortë ndaj Antonio Blancos gjatë fitores të Real Madridit kundër Alavesit me rezultatin 1-0. Sulmuesi francez e kuptoi menjëherë gabimin dhe bëri përpjekje ta

korrigjojë. Sipas "AS", Mbappe shkoi direkt në dhomat e zhveshjes së Alavesit pas ndeshjes për t'i kërkuar falje "Blancos". Mbappe iu drejtua edhe bashkëlojtarëve të Real Madridit, duke shprehur

keqardhjen që i la pa një lojtar në fushë. Veprimet e sulmuesit u nxitën nga zhgënjimi, veçanërisht pasi ky ishte kartoni i tij i parë i kuq që nga viti 2019. Pavarësisht prej pengesës, Real Madridi ishte

me fat, me Alavesin që humbi një lojtar, pasi Manu Sanchezit iu dha një karton i kuq më vonë në ndeshje. Blanco e pranoi faljen e Mbappes pa asnjë problem, me mesfushorin e Alavesit që

shpjegoi bisedën me francezin. "Ishte një ndërhyrje e fortë. Unë fola me Kylian. Ai kërkoj falje dhe nuk ka asnjë problem. Këto janë veprime që mund të ndodhin në futboll", ka deklaruar Mbappe.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1906  
0.5L

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

